

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**Fakulteti Juridik**

**STUDIMET POSTDIPLOMATIKE-MASTER**

**PROGRAMI E DREJTA CIVILE DHE**

**PRONËSORE**



**PUNIMI I DIPLOMËS MASTER**

***TEMA: “E DREJTA E ADOPTIMIT TË TË HUAJVE NË  
REPUBLIKËN E KOSOVËS, PROCEDURA DHE KUSHTET”***

**Mentori**

**Prof. Asoc. Dr. Bedri Bahtiri**

**Kandidatja:**

**Dife Latifi**

**Prishtinë, shkurt 2024**

## **Abstrakti**

*Ky punim trajton Adoptimin e fëmijëve në përgjithësi e në veçanti Adoptimin e fëmijëve në Kosovë nga shtetasit e huaj. Punimi fokusohet në mundësinë e shtetasve të huaj të adoptojnë në Kosovë, kushtet dhe procedurat të cilat kërkohen nga legjislacioni Kosovar për rastet e Adoptimit ndërkombëtar.*

*Adoptimi ndërkombëtar paraqet një proces të komplikuar që përfshinë transferimin e fëmijëve nga vendi i tyre i lindjes tek familjet Adoptuese jashtë vendit, proces ky i ndërlidhur me fusha ligjore, kulturore, sociale, etike, dhe psikologjike. Adoptimi është një përvojë që ndryshon jetën për të gjithë njerëzit e përfshirë duke filluar nga fëmija, prindërit adoptuese si dhe të tjerët që kanë pasur një rol gjatë procesit të Adoptimit. Përmes Adoptimit në njërën anë fëmijës Adoptues po i jepet mundësia që e meriton çdo fëmijë në botë e që është mundësia për tu rritur pranë familjes, ndërsa në anën tjetër prindërve po ju jepet mundësia ta kenë një fëmijë të vetin që ta rrisin me dashurin e tyre më të madhe.*

*Në Kosovë institutit të Adoptimit ndërkombëtar i është kushtuar shumë pak vëmendje e kjo vërehet në radhë të parë në mungesën e literaturës akademike, por edhe në mungesën e rregullimit të këtij instituti më hollësisht me Ligjin për Familje të Kosovës. Andaj fokusi i këtij punimi do të jetë paraqitja hapë pas hapi të zhvillimit të procedurës së Adoptimit Ndërkombëtar duke filluar me shqyrtimin e legjislacionit vendor e duke përfunduar me legjislacionin ndërkombëtar sidomos të Konventës së Hagës për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin në lidhje me adoptimin ndërshtetëror, duke analizuar efikasitetin e saj në mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenies së fëmijëve të adoptuar.*

*Për më tepër, kjo temë eksploron edhe dinamikën socio-kulturore që paraqitet me rastin e Adoptimit ndërkombëtar, duke përfshirë këtu sfidat ligjore, shqetësimet etike, dallimet kulturore midis vendeve dërguese dhe pritëse, por njëkohësisht trajtohen edhe sfidat të cilat paraqiten gjatë dhe pas këtij procesi.*

*Fjalët kyqe: fëmijë, Adoptim, ndërkombëtar, ndërshtetëror, ligj, shtetasit e huaj, interesi më i mirë i fëmijës, prindërit adoptues.*